VENDIM
Nr. 215, datë 20.4.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SISTEMIMI I BLLOKUT TË BANIMIT NË LAGJEN "KADRI QYSTRI", LUSHNJË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Sistemimi i bllokut të banimit në lagjen "Kadri Qystri", Lushnjë".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë "truall", me vlerë 1 281 588 (një milion e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasurinë "truall", prej 1 281 588 (një milion e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronari i përmendur në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasurinë e shpronësuar.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë dhe Bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1
LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE DHE VLERA E SHPRONËSIMIT, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT: "SISTEMIMI I BLLOKUT TË BANIMIT NË LAGJEN "KADRI QYSTRI", LUSHNJË

Vlera e shpronësimit e truallit të z. Thoma Sotir Semini
Investitori: Bashkia Lushnjë

Nr.	Nr/pasurisë	Emër, mbiemër	Zona kadastrale	Lloj i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
1	11/183	Thoma Semini	8571	Truall	m²	132	9709	1,281,588	Shkresa nr. 1922/1 date 20.03.2017
Vlera totale e shpronësimit 1,281,588									